

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5565  
E shtunë, 1 shtator 2018  
çmimi 0.40 €

## Pacolli: Evropa nuk mund të jetë e plotë pa integrimin e Ballkanit

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

EDHE TË PREMTEN KA VAZHDUAR DEBATI LIDHUR ME IDENË PËR KORRIGJIMIN E KUFIRIT NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË

FAQE 4-5

# Veseli dhe Haradinaj kundërshtojnë idenë për korrigjimin e kufirit



Pavarësisht prej takimeve të shpeshta në ditët e fundit, liderët shtetërorë nuk kanë arritur t'i bashkojnë qëndrimet sa i përket dialogut, përkatësisht idesë për korrigjimin e kufirit me Serbinë. Kryeministri Ramush Haradinaj edhe një herë e ka kundërshtuar këtë ide, duke thënë se nuk do të jetë pjesë e asnjë tavoline ku diskohet çështja e kufirit dhe territori i Kosovës. Edhe lideri i PDK-së, njëherësh kryetar i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, është shprehur kundër korrigjimit të kufirit me Serbinë, duke thënë se shteti, sovraniteti dhe integriteti territorial i Kosovës janë të shenjtë. Ai ka theksuar se askush nuk ka të drejtë, legjitimitet dhe forcë që të bëjë pazare me Serbinë në dëm të Kosovës

## Analistët: Opozita s'mund ta rrëzojë Qeverinë

Njohësit e rrethanave politike kanë shprehur skepticizëm se kjo opozitë do të mund ta rrëzojë qeverinë aktuale. Analistët Shkëlzen Maliqi dhe Behxhet Shala kanë deklaruar për gazetën "Epoka e re" se opozita nuk do të mund t'i bëjë numrat për të ngrhur mocion mosbesimi ndaj Qeverisë. LDK-ja ka paralajmëruar se në muajin shtator do ta iniciojë realizimin e një mocioni mosbesimi ndaj Qeverisë Haradinaj, kurse zyrtarët e kësaj të fundit kanë deklaruar se nuk i frikësohen asnjë iniciative të opozitës

FAQE 3



'Rruga e vdekjeve', banorët kërkojnë ndihmën e komunës dhe të Qeverisë

FAQE 7

### AKTUALE

**LAJM PËR 1 PRILL, BASHA E LUFTON KORRUPSIONIN, THAÇI E BASHKON LUGINËN E PRESHEVËS!**

F. 11

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



**OSBE-JA TRAJNON POLICINË PËR IDENTIFIKIMIN E DHUNËS NË FAMILJE**

F. 7

**ANËTARËSIMI I KOSOVËS NË INTERPOL, I DOMOSDOSHËM**

F. 7

### EKONOMI

**DERI NË 36 MUAJ TRAJTIMI I RASTEVE TË BIZNESEVE NË GJYKATËN THEMELORE NË PRISHTINË**

F. 8

**AKP-JA MIRATON LISTËN PËR SHITJEN E 42 ASETEVE**

F. 8

### KULTURË

**DITARI I PROFESORIT**

F. 13

Nga Fakulteti Filozofik drejt ndërtesës së burgut

Shkruan: Ismail SYLA

### SPORT

**FERONIKELI KËRKON MAKSIMUMIN NDAJ BALLKANIT**

F. 14

**GREZDA: TRANSFERIMI TE RANGERSI, HAP I MADH NË KARRIERËN TIME**

F. 14

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Vuesha, p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Brazili me ambasador të ri në Tiranë

**TIRANË, 31 GUSHT** - Francisco Carlos Ramalho de Carvalho Chagas do të jetë ambasadori i Brazilit në Tiranë, i cili të premten i ka paraqitur Letrat Kredenciale presidentit Meta. Presidenti Meta vlerësoi marrëdhëniet shumë të mira e miqësore midis dy vendeve, që të dy vendet kanë ndërtuar prej 6

dekadash. Në mënyrë të veçantë ai vlerësoi se këto marrëdhënie janë shtuar më shumë si në nivel dypalësh, po ashtu edhe në atë shumëpalësh, veçanërisht pas hapjes së ambasadave në kryeqytetet respektive të të dy vendeve. Duke u ndalur në mundësitë e rritjes së

bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar, presidenti Meta nënvizoi se mundësitë janë të shumta. "Nuk mjafton vetëm fakti se Brazili është partneri i parë tregtar ndër vendet e Amerikës Latine, por ato duhet të rriten më shumë, në të gjitha fushat", tha presidenti Meta.



# Pacolli: Evropa nuk mund të jetë e plotë pa integrimin e Ballkanit

Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, ka thënë në Vjenë se Evropa paraqet një lloj mozaiku i cili nuk do të jetë i plotë pa integrimin e Republikës së Kosovës dhe të Ballkanit Perëndimor. Ai ka thënë se pavarësia e Kosovës është një realitet dhe fakt i pamohueshëm



**PRISHTINË, 31 GUSHT (ER)** - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, me ftesë të eurodeputetit Lukas Mandl, i cili njëkohësisht është edhe kryetar i Shoqatës së Miqësisë Austri - Kosovë, ka mbajtur një ligjëratë mbi zhvillimet aktuale në Kosovë në "Shtëpinë e Unionit Evropian në Vjenë". Në fjalën e tij, Pacolli ka falënderuar Austrinë dhe qytetarët e saj për mbështetjen e vazhdueshme për afirmimin e Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare.

vend, duke u fokusuar edhe në sfidat e brendshme dhe të jashtme të Republikës së Kosovës. "Pavarësia e Kosovës është një realitet dhe fakt i pamohueshëm. Republika e Kosovës paraqet një storie të suksesit, jo vetëm të angazhimit të bashkësisë ndërkombëtare, por edhe të bashkëjetesës ndërmjet qytetarëve të saj me përkatësi të ndryshme etnike dhe fetare. Këta 10 vjet janë një sukses enorm, me të cilin duhet të jemi krenarë", ka thënë Pacolli.

Para të pranishmëve Pacolli ka paraqitur një bilanc dhjetëvjeçar të zhvillimeve të përgjithshme në

Duke folur për rrugën evropiane të Republikës së Kosovës, Pacolli ka thënë se votimi i Komitetit për Çështje të Brendshme në

Parlamentin Evropian (LIBE) për heqjen e vizave për Kosovën është dëshmia më e mirë e vendosmërisë dhe përkushtimit të Kosovës për përmbushjen e të gjitha zotimeve, objektivave dhe detyrimeve që dalin nga procesi

integruar. "Evropa paraqet një lloj mozaiku, i cili nuk do të jetë i plotë pa integrimin e Republikës së Kosovës dhe të Ballkanit Perëndimor", ka thënë Pacolli. Ndërsa në lidhje me dialogun që është duke u zhvilluar në

Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë, Pacolli ka thënë se vazhdimisht ka qenë në përkrahje të dialogimit dhe zgjidhjes së problemeve fqinjësore bilaterale në mënyrë paqësore.

## Basha paralajmëron Ramën për përplasje civile

**TIRANË, 31 GUSHT** - Opozita po për-gatitet për reagime të forta në rast se mazhoranca do të votojë në Kuvend dekretin e presidentit që rrezoi Ligjin për godinën e re të Teatrit Kombëtar. Në bashkëbisedimin me gazetarët, lideri demokrat Lulzim Basha apeloj kryeministrin Rama ta tërheqë Ligjin për shembjen e teatrit apo ligjin 'Fusha', sikundër



e cilëson ai. "Të tërhiqet menjëherë pa bërë gëk-mëk. Shansin ia ka dhënë presidenti me

kthimin e ligjit. E përshëndes personalisht këtu kreun e shtetit. Ta tërheqë ligjin Fusha, mos t'i shkojë ndërmend ta sjellë në seancë, se do të përballet me pasojat më të paparashikueshme. Do të jetë shpallje e konfrontimit dhe e përplasjes civile", tha ai. Ndërsa e konsideroi Ligjin për shembjen e teatrit si vijën e kuqe, Basha apeloj kryeministrin Rama

të mos e kalojë atë, pasi pasojat do të jenë të paparashikueshme. "Miratimi i ligjit në parlament do të thotë ta asgjësosh Kushtetutën, ta grabitësh pronën publike për t'i pastruar paratë e drogës. Ajo është vija e kuqe, pastaj gjithçka do të jetë në dorë të qytetarëve dhe këtu nuk dikton më opozita", tha Basha. Mazhoranca ka planifikuar që më

datën 13 ta fusë në seancën e parë parlamentare për këtë sesion rivotimin e Ligjit për Teatrin Kombëtar. Dy muaj më parë kreu i shtetit e ktheu ligjin duke e cilësuar si antikushtetues. Por, pavarësisht prej vendimit të presidentit, kundërshtive të artistëve dhe kundërshtive të opozitës, Partia Socialiste është e vendosur për kalimin e ligjit.

## Kryemadhi: Vendi është në alarm, Rama po grabit shtetin!

**TIRANË, 31 GUSHT** - Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim ka thënë se vendi ndodhet në një alarm të madh për shkak të krimit dhe trafikut të drogës. Në një takim me strukturat e LSI-së, Kryemadhi e etiketoi kryeministrin Rama si "të

çmendur" që po shkatërron të ardhmen e të rinjve shqiptarë. "Shqipëria është në një alarm të madh dhe ne këtij alarmi duhet t'i përgjigjemi menjëherë. Krimi nuk ka më frikë nga shteti, se shteti është në krah të tyre. Raportohet

për 150 mijë të rinj përdorues të kokainës. Kryekrimineli, që kemi kryeministër, është ai që drejton dorën e kimit ndaj shqiptarëve. Qindra e mijëra të rinj po largohen nga vendi. Prandaj misioni i rinisë shqiptare është për ta ndryshuar

këtë realitet të hidhur", tha ajo. Kryemadhi u shpreh se të hënën do të nisë një sesion shumë i vështurë parlamentar me çështjen e Teatrit Kombëtar që, sipas saj, po tentohet të grabitet nga kryeministri Rama.





Qeveria nuk i frikësohet rrëzimit nga mocioni i opozitës

# Analistët: Opozita s'mund ta rrëzojë Qeverinë



Njohësit e rrethanave politike kanë shprehur skepticizëm se kjo opozitë do të mund ta rrëzojë qeverinë aktuale. Analistët Shkëlzen Maliqi dhe Behxhet Shala kanë deklaruar për gazetën "Epoka e re" se opozita nuk do të mund t'i bëjë numrat për të ngrehur mocion mosbesimi ndaj Qeverisë. LDK-ja ka paralajmëruar se në muajin shtator do ta iniciojë realizimin e një mocioni mosbesimi ndaj Qeverisë Haradinaj, kurse zyrtarët e kësaj të fundit kanë deklaruar se nuk i frikësohen asnjë iniciative të opozitës

janë të vetëdijshëm se nuk i kanë votat për rrëzimin e Qeverisë, më shumë bëhet fjalë për retorikë. Po kështu, ndoshta edhe i frikësohen pushtetit në këtë periudhë kur pritet të aktivizohet Gjykata Speciale dhe të arrihet marrëveshja gjithëpërfshirëse me Serbinë. LDK-ja do të bënte mirë nëse do ta ndihmonte procesin e dialogut duke u dëshmuar si parti institucionaliste", është shprehur Maliqi.

Edhe analisti tjetër politik Behxhet Shala ka deklaruar për gazetën se kjo opozitë nuk do të mund të realizojë një mocion mosbesimi ndaj Qeverisë dhe ta çojë vendin në zgjedhje të parakohshme. "Mund të kërkojë çfarë të dojë, por zgjedhje nuk do të ketë. Në rrethanat normale faktori ndërkombëtar kurrë nuk do të pranonte që Kosova të udhëhiqet nga Thaçi, Veseli e Haradinaj, mirëpo këta u duhen për vendime me muskujt të cilët edhe mund të jenë të kushtueshëm, por nuk ndërrohet ekipi", ka thënë Shala. Sipas tij, opozita është e vetëdijshme se nuk mund ta rrëzojë qeverinë aktuale. "Jo, nuk do të ketë zgjedhje. Këtë e di shumë mirë edhe LDK-ja, edhe Vetëvendosja. Madje e dinë se edhe po të kishte zgjedhje nuk do të mund t'i fitonin ato. Zgjedhjet varen edhe

nga ndërkombëtarët të cilët në asnjë mënyrë nuk do të lejojnë të organizohen në këtë fazë", është shprehur Shala.

Megjithatë, LDK-ja është optimiste se mund t'i mbledhë votat e mjaftueshme për ta rrëzuar Qeverinë Haradinaj në muajin shtator. "Ne kemi biseduar me deputetët e partive në pushtet, të cilët janë shumë të pakënaqur me gjendjen aktuale. Jemi optimistë se pas këtij organizimi opozitar dhe pas këtij presioni qytetar do t'i sigurojmë votat e nevojshme për rrëzimin e Qeverisë, e cila është Qeveria më e dëmshme për vendin që nga viti 1945. Pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme duhet të formohet një Qeveri kredibile për ta nxjerrë Kosovën nga ky vorbull dhe nga ky depresion kolektiv", ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" deputeti i LDK-së, Naser Rugova, duke shtuar se janë në rrugë të mirë për ta arritur këtë qëllim. "Nuk dua të flas për data, por jemi në rrugë të mirë dhe nuk do të ndalemi deri në rrëzimin e Qeverisë Haradinaj", ka thënë Rugova.

Paralajmërimeve të LDK-së nuk u frikësohet Qeveria. Përfaqësuesit e kësaj të fundit paralajmërimet për mocionin i kanë quajtur joserioze. Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka

deklaruar për gazetën "Epoka e re" se refrenin e mocionit LDK-ja e ka përsëritur prej se Haradinaj ka marrë drejtimin e Qeverisë. "Tashmë Qeveria Haradinaj është afër njëvjetorit që nga marrja e përgjegjësisë dhe pothuajse gjatë gjithë këtyre muajve kemi dëgjuar të njëjtin refren të partive opozitare, e sidomos të LDK-së, që do të organizojë mocion mosbesimi. Prandaj, unë nuk i marr shumë serioze këto deklarime dhe nuk frikësohem nga rrëzimi i Qeverisë. Nëse opozita do ta kishte shumicën e Kuvendit, ne do të dorëhiqeshim nga pozita", ka thënë Lekaj.

As ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, i cili vjen nga radhët e PDK-së, nuk i frikësohet mocionit të mosbesimit nga opozita. "Opozita duhet të ketë rol aktiv dhe të orientuar në debatet që lidhen me cilësinë e qeverisjes e jo vetëm të orientohet në debatet politike se kush është duke qeverisur dhe me kë. Prandaj, ne nuk kemi pse të frikësohem nga mocionet e votëbesimit, as nga iniciativat e tjera opozitare sepse në esencë një opozitë produktive është në të mirë edhe të Qeverisë. Kjo, megjithatë, nuk e amnistion opozitën që të kërkojë zgjedhje të reja pa arsye, vetëm se është opozitë", ka deklaruar Tahiri.

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 31 GUSHT** - Njohësit e rrethanave politike në vend nuk besojnë se opozita do të mund ta realizojë një mocion të suksesshëm mosbesimi ndaj Qeverisë Haradinaj. Sipas tyre, ka bllokadë të numrave brenda Kuvendit që nuk mund të zbërthehet lehtë. Ndonëse opozita ka paralajmëruar një mocion ndaj Qeverisë në muajin shtator, zyrtarët e koalicionit qeverisës nuk po i frikësohen këtij mocioni. Njohësi i proceseve politike në vend, Shkëlzen Maliqi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se kjo Qeveri e ka gjetur modusin e mbijetesës në faktin se opozita nuk po mund t'i mbledhë votat

për mocion të mosbesimit. "Opozita ka hapësirë të vogël manovruese sepse nuk ka ofertë të prekshme dhe premtuese për partnerë koalicioni as me LV-në e as disa parti që janë tani në pushtet dhe do të mund të aspironin më shumë në një qeveri tjetër. Ashtu sikur që kemi pasur bllokadën e mungesës së numrave dhe të alternativave në vitet 2014-2015, tani kemi një bllokadë të numrave brenda Kuvendit që nuk mund të zbërthehet lehtë, edhe për shkakun se e kaluara e ka djegur besimin mes shumë partive dhe ato nuk po llogarisin në kombinime të reja të koalicioneve", ka thënë Maliqi.

Ai ka treguar se opozita këtë e ka më shumë si retorikë. "Derisa



Edhe të premten ka vazhduar debati lidhur me idenë për korrigjimin e kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë

# Veseli dhe Haradinaj kundërshtojnë

Pavarësisht prej takimeve të shpeshta në ditët e fundit, liderët shtetërorë nuk kanë arritur t'i bashkojnë qëndrimet sa i përket dialogut, përkatësisht idesë për korrigjimin e kufirit me Serbinë. Kryeministri Ramush Haradinaj edhe një herë e ka kundërshtuar këtë ide, duke thënë se nuk do të jetë pjesë e asnjë tavoline ku diskohet çështja e kufirit dhe territori i Kosovës. Edhe lideri i PDK-së, njëherësh kryetar i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, është shprehur kundër korrigjimit të kufirit me Serbinë, duke thënë se shteti, sovraniteti dhe integriteti territorial i Kosovës janë të shenjtë. Ai ka theksuar se askush nuk ka të drejtë, legjitimitet dhe forcë që të bëjë pazare me Serbinë në dëm të Kosovës



**EPOKA  
ERE** Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 31 GUSHT** - Ideja për korrigjim të kufijve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si zgjidhje për arritjen e një marrëveshjeje juridikisht obliguese ndërmjet dy vendeve, e cila është proklamuar nga presidenti Hashim Thaçi, nuk ka arritur ta sigurojë unitetin e spektrit politik, madje as të partive brenda koalicionit qeverisës.

Ndërkaq partitë opozitare kanë kërkuar një seancë të jashtëzakonshme më 4 shtator, për të debatuar lidhur me, siç është thënë, "angazhimet e presidentit të Kosovës për përfshirjen e 'shkëmbimit të territoreve' apo 'korrigjim të kufijve' në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë".

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), njëherësh kryetar i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë të premten se në asnjë mënyrë dhe për asnjë çmim nuk do të lejohet cenimi i sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst, ai ka bërë me dije se është i papranueshëm Asociacioni i Komunave Serbe me kompetenca ekzekutive. "Qëndrimi i Partisë

Demokratike të Kosovës është konsistent dhe i qartë: Në asnjë mënyrë nuk do të lejohet cenimi i sovranitetit të Kosovës, i integritetit territorial të shtetit tonë dhe i Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Asociacioni me kompetenca ekzekutive është i papranueshëm", ka deklaruar Veseli në një konferencë për medie të mbajtur në selinë e partisë të premten. Ai është shprehur kundër idesë për korrigjim të kufirit me Serbinë, duke thënë se shteti, sovraniteti dhe integriteti territorial i Kosovës janë të shenjtë.

Veseli ka theksuar se askush në Kosovë nuk ka të drejtë dhe legjitimitet për të bërë pazare me Serbinë. "Jam për Kushtetutën e Republikës së Kosovës, për sovranitetin dhe integritetin territorial. Për aq sa

kam fuqi, dije dhe mundësi do të luftoj për shqiptarët në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, që të trajtohen siç i trajtojmë serbët në Kosovë. Për asnjë çmim nuk lejojmë cenimin e shtetit tonë. Kemi dhënë shumë gjak, prandaj nuk bëhen lojëra me çështjen e Kosovës. Nuk ka njeri në Kosovë që ka të drejtë dhe legjitimitet të bëjë pazare me Serbinë. Shteti, integriteti dhe sovraniteti janë të shenjtë dhe do të jenë të shenjtë për jetë. Kemi bërë shumë sakrifica për këtë shtet dhe do ta ruajmë deri në fund", është shprehur Veseli kur është pyetur nëse e përkrah apo jo idenë për korrigjimin e kufirit me Serbinë.

Më tutje, Veseli ka thënë se shqiptarët e Luginës së Preshevës janë qytetarët më të diskriminuar dhe Kosova nuk

do t'i lë në stuhi. "Shteti i Kosovës ka obligim për të qenë afër tyre dhe nuk do t'i lëmë në stuhi. E kemi një kushtetutë mbi bazën e së cilës e ndërtojmë krejt shtetin tonë dhe ajo është e shenjtë. Kemi kufijtë territorialë dhe për disa hektarë me Malin e Zi na u kanë dashur tri vjet. Jemi të ndejshëm për çështjen e kufijve. Nuk ka shqiptar në botë që ka qejf më shumë se unë që Presheva, Medvegja dhe Bujanoci t'i bashkohen Kosovës sepse ata janë duke vuajtur dhe e meritojnë të jenë në Kosovë. Ky është realiteti ynë historik. Kemi ndërtuar këtë përpjekje dhe ata kanë marrë pjesë në luftën e UÇK-së dhe në rezistencën paqësore, në të njëjtën kohë më 17 shkurt kanë qenë pjesë aktive e ndihmës sonë. Do të punojmë për ta gjithmonë", ka

theksuar Veseli, duke shtuar se Kosovës i duhet konsensusi kombëtar për ballafaqim me Serbinë. Sipas tij, jo ndarje në mes vete për përfitime elektorale. Veseli ka vlerësuar se seanca e jashtëzakonshme e thirrur nga opozita është dëmi më i madh që i shkaktohet Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran dhe partneritetit me bashkësinë ndërkombëtare. "Legjitimimi i temës së ndarjes në Kuvendin e Kosovës pa fakte, pa argumente dhe me Kushtetutë të qartë është vetëm inskenim i lojës së papranueshme për ndarje, që është skenar jashtë Kosovës, ShBA-së dhe BE-së. PDK-ja konsideron se ngritja e kësaj teme të rrezikshme në diskursin e brendshëm politik do ta dëmtojë Kosovën në procesin e dialogut, duke krijuar



# idenë për korrigjimin e kufirit



Kosovës", ka theksuar ai. Por para mbajtjes së kësaj konference, Haradinaj ka shkruar një status në llogarinë e vet në "Facebook", në të cilin ka thënë se debati për ridizajnimin e kufijve është ftesë për tragjedi të reja në Ballkan. "Diskutimi i vazhdueshëm publik mbi ridizajnimin e kufijve dhe shkëmbimin e territoreve është një ftesë për tragjedi të reja në Ballkan, i cili çon në destabilizim, pasiguri dhe rrezikon investimet afatgjata politike dhe të sigurisë për stabilitetin dhe paqen në Kosovë dhe rajon. Si kryeministër i Republikës së Kosovës do të vazhdoj fuqishëm të qëndroj kundër këtyre ideve shkatërruese dhe u bëj thirrje të gjitha vendeve mike dhe institucioneve ndërkombëtare kontribuuese për Kosovën, t'i kundërshtojnë idetë shkatërruese dhe të mos lejojnë që ato të arrijnë në

tryezën e vendimmarrjes", ka deklaruar Haradinaj. Ai ka thënë se marrëveshja përfundimtare ligjërisht e obligueshme midis Kosovës dhe Serbisë do të jetë një hap vendimtar për sigurimin e stabilitetit dhe paqes në rajonin tonë. "Njohja reciproke dhe paqja e qëndrueshme duhet të jenë rezultati i vetëm kredibil nga kjo marrëveshje", është shprehur Haradinaj.

**Thaçi: Thirrjet për tragjedi të reja në Ballkan meritojnë të hidhen në shportë**

Por ndaj deklaratës së kryeministrit Haradinaj ka reaguar presidenti Hashim Thaçi, duke thënë se thirrjet për luftë dhe tragjedi të reja në Ballkan i takojnë mentalitetit të shekullit të kaluar dhe, si të tilla, meritojnë të hidhen në shportë".

jnë të hidhen në shportë. "Të gjitha shtetet perëndimore, aleatët tanë, garantuesit e paqes dhe të sigurisë në Ballkan po bëjnë përpjekje dhe thirrje për paqe, stabilitet dhe arritje të marrëveshjes përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kjo marrëveshje nënkupton njohje reciproke dhe perspektivë të sigurt të anëtarësimit të Kosovës në BE, NATO dhe OKB. Por, fatkeqësisht, individë të caktuar në vendin tonë, me veprimet e tyre po tentojnë të krijojnë panik dhe konfuzion. Kosova mbetet e përkushtuar për dialog dhe arritje të marrëveshjes paqësore përfundimtare. Thirrjet për luftë dhe tragjedi të reja në Ballkan i takojnë mentalitetit të shekullit të kaluar dhe, si të tilla, meritojnë vetëm të hidhen në shportë", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

## Vazhdon bashkëpunimi FSK-KFOR

PRISHTINE, 31 GUSHT - Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rustem Berisha, ka pritur të premten në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Salvatore Cuoci. Ministri Berisha dhe gjenerali Cuoci biseduan për situatën e sigurisë në vend, bashkëpunimin në mes të FSK-së dhe KFOR-it si dhe për hapat e mëtejshëm të thellimit të bashkëpunimit dhe koordinim-

it të vazhdueshëm në të mirë të zhvillimit dhe profesionalizimit të mëtejshëm të FSK-së si dhe për ruajtjen dhe kultivimin e një klime bashkëpunimi gjithnjë në të mirë të paqes, stabilitetit dhe prosperitetit në Kosovë. I pari i FSK-së ka falënderuar komandantin e KFOR-it për angazhimin e tij dhe të trupave paqeruajtëse të KFOR-it për gjithë kontributin që po japin

në vazhdimësi për garantimin e paqes dhe stabilitetit në vend. Gjatë takimit ministri Berisha dhe gjenerali Cuoci kanë koordinuar agjendën dhe ritmet e takimeve të përbashkëta për të ardhmen me qëllim informimi, koordinimi dhe angazhimi të përbashkët në të mirë të paqes dhe stabilitetit në Republikën e Kosovës, duke qenë në shërbim të gjithë shoqërisë.



argumente pikërisht në favor të eksponentëve kundër Kosovës që dëshirojnë ndarjen e Kosovës", ka thënë Veseli. Ai ka bërë me dije se grupi parlamentar i PDK-së do të marrë pjesë në seancën e jashtëzakonshme për dialog për ta prezantuar qëndrimin e qartë i cili buron nga lufta e UÇK-së dhe nga 17 shkurti i 2008. Sipas Veselit, Kosova nuk ka aleatë më të mirë se Amerika.

**Haradinaj: Diskutimi mbi ridizajnimin e kufijve, ftesë për tragjedi të reja në Ballkan**

Ndërsa kryeministri i Kosovës, njëherësh lider i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka qenë edhe më i qartë lidhur me qën-

drimin e tij për korrigjimin e kufirit pas takimit me liderët shtetërorë. Ai në një konferencë për medie ka thënë se është i vendosur se nuk do të ketë diskutim për territorin dhe kufijtë në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. Haradinaj ka theksuar se Kosova nuk ka të drejtë, madje është logjike e gabuar të kthehet e të diskutojë për atë që ka arritur. "Unë ju siguroj se pozicioni im është i qartë. Në atë moment që hapet kjo temë, unë nuk jam në atë tavolinë më. Unë nuk do të qëndroj në një tavolinë ku hapet kjo temë. Edhe brenda nesh nëse flet dikush për ndonjë opsion për t'u marrë vesh me Serbinë, atëherë unë nuk jam në tavolinë. Jam pro vazhdimin të dialogut dhe arritjes së marrëveshjes, por jo të diskutohet për kufirin dhe territorin e



# Anëtarësimi i Kosovës në Interpol, i domosdoshëm

Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, gjatë takimit me sekretarin e përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Austrisë, Peter Goldgruber, ka theksuar se anëtarësimi i Kosovës në Interpol është i domosdoshëm, për ta garantuar dhe forcuar sigurinë dhe stabilitetin në rajon dhe më gjerë



**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 31 GUSHT** - Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, po qëndron në një vizitë zyrtar për Austri, ku është pritur nga sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Austrisë, Peter Goldgruber. Në këtë takim është biseduar për tema të cilat kanë të bëjnë me migrimin, terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, liberalizimin e vizave si dhe për përfshirjen e Policisë së Kosovës në organizatën Interpol. Me këtë rast, ministri Gashi ka falënderuar Qeverinë e Austrisë për mbështetjen e Kosovës në proceset e integritetit euroatlantik, si dhe për përkrahjen ndaj institucioneve të Kosovës për forcimin e kapaciteteve. "Shfrytëzojmë rastin t'ju falën-

derojmë për përkrahjen e madhe që Austria i ka dhënë popullit të Kosovës dhe presim që përkrahja juaj të vazhdojë për liberalizimin e vizave, në procesin e anëtarësimit të Kosovës në Interpol dhe organizata të tjera ndërkombëtare, si dhe për perspektivën e Kosovës në Bashkimin Evropian", ka thënë ministri Gashi.

Ministri Gashi ka theksuar se terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm vazhdojnë të mbeten një nga kërcënimet kryesore të sigurisë, duke kërcënuar jo vetëm jetën dhe pronën, por edhe vlerat demokratike dhe mënyrën e jetës së shoqërisë. Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës dhe institucionet e saj mbeten të përkushtuara për ta dhënë ndihmën e tyre për t'i luftuar këto fenomene. "Është lajm i mirë që Komiteti për Liritë Qytetare,

Drejtësi dhe Çështje të Brendshme - LIBE, me shumicë votash ka rekomanduar liberalizimin e vizave, hap ky shumë i rëndësishëm drejt lëvizjes së lirë për qytetarët e Kosovës. Zotohem se MPB do të mbetet e përkushtuar për menaxhimin efikas të procesit pas liberalizimit të vizave dhe obligimeve që dalin nga lëvizja e lirë në

Zonën Shengen", ka thënë ministri Gashi. Gjithashtu, ministri Gashi ka pohuar se anëtarësimi i Kosovës në Interpol është i domosdoshëm për të garantuar dhe forcuar sigurinë dhe stabilitetin në rajon dhe më gjerë. Ndërsa sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Austrisë, Peter Goldgruber, ka konfirmuar

mbështetjen e shtetit austriak për përmbushjen e objektivave në proceset e integritetit euroatlantik. Gjithashtu, Goldgruber ofroi gatishmërinë për bashkëpunimin në mes të dy policive sa i përket shkëmbimit të informatave, të cilat do të ndihmonin për luftimin e terrorizmit dhe krimin të organizuar.

## Avokati i Popullit: Votimi nëpërmjet postës, metodë e pasigurt

**PRISHTINË, 30 GUSHT (ER)** - Avokati i Popullit ka publikuar raportin me rekomandime me qëllim të ngritjes së çështjes së organizimit të votimit jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare dhe lokale tek autoritetet përgjegjëse.

Raporti bazohet në analizën e legjislacionit vendor si dhe në standardet ndërkombëtare lidhur me organizimin dhe mbarëvajtjen e proceseve zgjedhore parlamentare dhe lokale, me fokus në organizimin e votimit jashtë vendit.

Raporti i Avokatit të Popullit trajton tri çështje me interes për organizimin e votimit jashtë vendit. Çështja e parë ka të bëjë me publikimin e rezultateve përfundimtare të votave jashtë vendit. Lidhur me këtë, Avokati i Popullit konstaton se korniza ligjore e Republikës së Kosovës parasheh ushtrimin e së drejtës së votës jashtë vendit. Nisur nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), kur shteti i mundëson zgjedhjet jashtë vendit dhe garanton atë me kornizën ligjore në fuqi, është detyrim i shtetit t'i organizojë zgjedhjet në mënyrë të mirëfilltë dhe transparente. Megjithatë,

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk parasheh publikim të rezultateve përfundimtare të votave nga jashtë. Së këndejmi, Avokati i Popullit ka rekomanduar Ndryshim/Plotësimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, në nenin 106, paragrafi 4, ku do të përfshihet edhe publikimi i rezultateve përfundimtare të votave nga jashtë vendit.

Çështja e dytë ka të bëjë me rregullën zgjedhore të KQZ-së për votim jashtë vendit, e cila parasheh mënyrën e votimit nëpërmjet kutive postare të vendosura nga KQZ-ja, por nuk jep sqarim në lidhje me vendndodhjen e këtyre kutive postare. Duke u bazuar në standardet ndërkombëtare, votimi nëpërmjet postës, për votimin jashtë vendit, konsiderohet metodë e pasigurt, e brishtë dhe jo transparente. Së këndejmi, Avokati i Popullit ka rekomanduar Ndryshim/Plotësimin e Rregullës Zgjedhore 03/2013 neni 4, i cila do të duhej ta përfshijë përcaktimin e vendndodhjes së kutive zgjedhore dhe rolin e zyrave konsullore/ambasadave në procesin zgjedhor.

Në frymën e çështjes së dytë,



Avokati i Popullit ka rekomanduar edhe Ndryshim/Plotësimin e Ligjit për Zgjedhjet e

Përgjithshme, neni 96, i cili do të mundësonte, përveç votimit me postë, edhe votimin fizik nëpër-

mjet zyrave konsullore apo ambasadave ku do të vendosehin kutitë e votimit.



# 'Rruga e vdekjeve', banorët kërkojnë ndihmën e komunës dhe të Qeverisë

Rruga e fshatit Gumnasellë dhe Qallapek e Komunës së Lipjanit, e cila bashkohet me magjistralen Prishtinë - Shkup, është e rrezikshme shumë. Banorët e këtyre fshatrave kërkojnë ndihmë të menjëhershme nga komuna dhe nga Qeveria. Ata kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se shpëtim në këtë drejtim është ndërtimi i një nënkalimi për këmbësorë

EPOKA  
ERE

Ismail REXHEPI

LIPJAN, 31 GUSHT - Rruga e fshatit Gumnasellë dhe Qallapek e Komunës së Lipjanit, e cila bashkohet me magjistralen Prishtinë - Shkup, është e rrezikshme shumë. Në këtë vend, duke kaluar magjistralen Prishtinë - Shkup, kanë humbur jetën disa persona. Prej tyre, shumica ishin nxënës të shkollës fillore dhe të mesme të dy fshatrave të lartpërmendura. Madje numri i aksidenteve të veturave, traktorëve e qerreve me kuaj është pothuajse i përditshëm. Në çdo ditë mësimi nxënësve

të ciklit të lartë të shkollës fillore të mesme të ulët, të fshatit Qallapek, u bie ta kalojnë magjistralen Prishtinë - Shkup për të shkuar në shkollën e fshatit Banullë e Gumnasellë. Ata, si gjatë vajtjes, po ashtu edhe kthimit nga shkolla, janë të rrezikuar deri në skajshmëri nga qarkullimi i shpejtë dhe i shumtë i automjeteve.

Ka dekada që banorët e Qallapekut kanë kërkuar ndihmë nga institucionet kompetente, pra jo vetëm nga komuna, por edhe ministritë kompetente për të bërë një zgjidhje që është e domosdoshme, në të kundërtën pasojat me fatalitet për banorët do të vazhdo-

jnë edhe më tutje. Jo vetëm nxënësit e shkollës fillore, por ngjashëm janë të rrezikuar edhe studentët, punëtorët, me një fjalë i gjithë fshati Gumnasellë, banorët e të cilit duhet ta kalojnë magjistralen për të hipur në autobusin që shkon për Prishtinë dhe

Lipjan.

Ndërsa qallapekasit janë të rrezikuar ngjashëm, pasi dalin për ta prituri autobusin që shkon për Ferizaj. Kështu, të shpeshta janë edhe rastet kur u ikën autobusi, sepse nuk mund për një kohë ta kalojnë magjistralen për shkak të automjeteve të shumta që janë në trafik. Shoferët nuk i presin derisa ta kalojnë magjistralen sepse atyre u bie të presin bukur shumë. "Nga fshati ynë ka pasur disa persona që kanë humbur jetën pasi janë goditur nga veturat. Numri më i madh i tyre kanë qenë nxënës të shkollës fillore. Për ditë këtu rreziku është i njëjtë, e sidomos në kohën kur punojnë shkollat. Edhe nxënësve të shkollave të mesme, studentëve, punëtorëve etj. u paraqitet rreziku i madh të cilët kthehen nga Prishtina për të hyrë në fshatin Qallapek, sepse duhet kaluar mbi magjistralen Prishtinë - Shkup.

I vetmi shpëtim në këtë drejtim është ndërtimi i një nënkalimi për këmbësorë. Këtu duhet një ndërhyrje e menjëhershme", ka thënë Nysret Podrimqaku nga fshati Qallapek.

Po një shqetësim të tillë e ka paraqitur edhe banori i fshatit Gumnasellë, Ismet Emini, i cili ka thënë se ky rrugëkryq për të gjithë është "rrugë e vdekjes". "Nuk ka ditë që këtu nuk aksidentohet dikush nga fshati ynë", ka pohuar ky banor i fshatit Gumnasellë, i cili ka bërë apel tek organet komunale dhe qendrore që sa më parë ta vënë nënkalimin në këtë rrugëkryq.

Rreziqe në kalimin e magjistrales Prishtinë - Shkup ka edhe në fshatin Llugaxhi dhe Babush i Muhaxherëve si dhe në Banullë e Konjuh, mirëpo dalja e këtyre banorëve në magjistralen në fjalë është më e vogël, sepse aty shumë rrallë kyçen banorët e një fshati.



## OSBE-ja aftëson policinë për identifikimin e dhunës në familje

EPOKA  
ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 31 GUSHT - Misioni i OSBE-së në Kosovë ka përmbyllur një kurs pesëditor të trajnimit të trajnerëve me temë identifikimin e dhunës në familje për njësitë e policisë në bashkësi. Ky kurs është mbajtur nga 27 deri më 31 gusht në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri. Kursi kishte në fokus indikatorët e hershëm, siç janë: dëshmitë fizike dhe shenjat psikologjike të viktimave; reagimi i parë i policisë dhe asistencën për viktimat e dhunës në familje dhe abuzimit seksual; si dhe ofrimi i sigurisë për policët dhe viktimat e përfshira. "Lufta kundër dhunës në familje është prioritet i misionit", ka deklaruar

Kilian Wahl, zëvendësues i Misionit të OSBE-së në Kosovë. Ai ka thënë se parandalimi është vendimtar për të siguruar ulje efektive të rasteve të dhunës në familje. "Ne mbështesim Policinë e Kosovës për zgjerimin e njohurive dhe shkathtësive të zyrtarëve policorë në aspektin e parandalimit. Kjo do të mundësojë identifikim të duhur të indikatorëve të hershëm të dhunës në familje dhe reagim para se të ndodhë diçka".

Ramadan Krasniqi, rreshter i policisë, ka pohuar se ky kurs ishte mundësi e shkëlqyer për të mësuar qasje të reja të rasteve të dhunës në familje. "Në të ardhmen duhet të përqendrohemi edhe në ndërgjegjësimin e opinionit publik mbi dhunën në famil-



je dhe për rritjen e bashkëpunimit tonë me ta për ta zvogëluar këtë fenomen negativ", ka thënë ai.

Pas këtij kursi pjesëmarrësit do të bëhen trajnerë të certifikuar dhe do të zhvillojnë kurse të ngjashme

trajnimi për policët e tjerë të patrullimit në stacionet e tyre policore.



## Rritja e rasteve të dhunës në familje në Pejë, shqetësuese

PEJË, 30 GUSHT (ER) - Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Pejës, Agim Kurmehaj, ka mbajtur të premtën takim me zyrtarët përgjegjës policorë nga stacionet policore brenda kompetencës të kësaj prokurorie dhe mbrojtësit e viktimave, me

qëllim të koordinimit sa më të mirë për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

Kryeprokurori Kurmehaj gjatë takimit është shprehur se është shqetësuese rritja e rasteve të dhunës në familje, sidomos në muajt e fundit. Ai ka kërkuar nga zyrtarët

përgjegjës koordinim të plotë mes institucioneve kompetente për ndërmarrjen e veprimeve sa më të shpejta për trajtimin e këtyre rasteve. Gjatë këtij takimi u tha se në rastet e kanosjeve, fillimisht të bëhet sigurimi i viktimës nga njësitet policore, më pas të

merren me ndjekjen e të dyshuarit, si dhe rastet recidive të dhunës në familje të trajtohen me prioritet dhe seriozitet. Gjithashtu, u konstatua se është e nevojshme të rritet bashkëpunimi me institucionet e tjera përgjegjëse për ngritjen e kapaciteteve dhe

kushteve nëpër qendrat strehimore ku trajtohen viktimat e dhunës në familje.

Vlen të theksohet se në Prokurorinë Themelore të Pejës për rastet e dhunës në familje është i caktuar një prokuror i cili merret ekskluzivisht me këto raste.

## Malisheva e gatshme për fillimin e vitit të ri shkollor

MALISHEVË, 31 GUSHT (ER) - Në kuadër të përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019, Drejtoria për Arsim dhe Edukim në Malishevë ka mbajtur takim me drejtorët e të gjitha institucioneve arsimore.

Drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Blerim Thaçi, ka uruar të gjithë drejtorët për fillimin e vitit të ri shkollor, njëkohësisht ka uruar drejtorët e rinj për angazhim në pranimin e detyrës së re. Thaçi ka pasqyruar aspekte të përgjithshme të përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor, përfshirë rinovimin e shkollave, mbajtjen e konkursit për plotësimin e kuadrit arsimor, krijimin e kushteve për angazhimin e koordinatorëve të

cilësisë në bashkëpunim me MASHT-in.

Viti shkollor 2018/2019 pritet të fillojë më 3 shtator për të gjitha shkollat, përjashtimisht në ndonjë institucion arsimor ku punimet për rinovimet e objekteve shkollore janë në përfundim e sipër. Në kuadër të përgatitjeve ka paraqitur para të pranishmëve realizimet dhe përgatitjet për furnizim me tekste mësimore, ku MASHT-i veç ka filluar të furnizojë me libra falas e shumë shpejt do të furnizohet edhe Komuna e Malishevës.

Në kuadër të përgatitjeve u diskutua nga të gjithë drejtorët për rinovimet e shkollave, furnizimin me material



higjienik, furnizimin me lëndë djegëse, furnizimin me material teknik. Gjithashtu, drejtorët e shkollave u informuan për kërke-

sat të cilat janë në procedurë e sipër në Zyren e Prokurimit. Të gjithë të pranishmit u pajtuan për angazhime sa më të përgjegjshme

në punë dhe për përkushtimin e komunitetit shkollor për arritjen e rezultateve sa më të mira në vitin shkollor 2018/2019.

## Hapet qendra e dhjetë informuese për shëndetin e gruas edhe në Klinë



KLINË, 31 GUSHT (ER) - Me në një ceremoni zyrtare të premtën janë hapur dyert e Qendrës Informuese për Shëndetin e Gruas "Klasat për Nëna" në Klinë, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF). Kjo iniciativë është bërë e mundur falë financimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe bashkëpunimit të Departamentit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të Komunës së Klinës, QKMF-së dhe Aksionit për Nëna dhe Fëmijë. "E kemi mirëpritur hapjen e Klasave për Nëna edhe në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Klinë si mundësi e jashtëzakonshme për shtrirjen e informimit të saktë dhe shumë të rëndësishëm të nënave dhe partnereve të tyre

për një shëndet më të mirë të tyre dhe të foshnjave të tyre", ka thënë dr. Hekuran Sejdiu, drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Klinës.

Ndërkaq përfaqësuesja e Aksionit për Nëna dhe Fëmijë, Labërie Çarreti-Sylejmani, ka thënë se Qendra e Dhjetë "Klasat për Nëna", e hapur tani edhe në Klinë, do të ofrojë shërbime edukative, aktivitete të mirëqenies fizike dhe psikike, informacione këshilluese për kujdesin para dhe pas lindjes, depresionin e paslindjes, ushqyerjen me gj, kujdesin për të sapolindurin, të ushqyerit e foshnjës, imunizimin si dhe kujdesin ndaj fëmijës. "Jemi të lumtur që interesimi nga nënat është rritur dhe kërkesa për

hapjen e qendrave informuese për shëndetin e gruas është çdo ditë e më i madh", është shprehur ajo.

Qendra Informuese në Klinë është e hapur çdo ditë pune për të gjitha gratë e vajzat e Klinës si dhe partneret e tyre. Orari i sesioneve do të jetë i publikuar në QKMF në Klinë, në uebfaqen e Aksionit për Nëna dhe Fëmijë si dhe grupin në rrjetet sociale të Qendrës "Klasat për Nëna". Kjo është qendra e dytë e cila po hapet përgjatë vitit 2018, ndërsa nga viti 2014, prej kur u themelua ky program, "Klasat për Nëna" janë të shtrira në nëntë komuna të Kosovës: Prishtinë, Ferizaj, Mitrovicë, Prizren, Kaçanik, Pejë, Shtërpçë, Dragash dhe tani në Klinë.

## Funksionalizohet sistemi i ujësjellësit në fshatin Kryeshëfc të Skenderajt

SKENDERAJ, 31 GUSHT (ER) - Është lëshuar në funksion ujësjellësi në fshatin Kryeshëfc të Skenderajt, duke bërë të mundur furnizimin me ujë të pijshëm për banorët e këtij fshati, përkatësisht në rrjetet të sistemit janë instaluar 100 shtëpi.

Sipas zyrtarit në Drejtorinë për Shërbime Publike të Komunës së Skenderajt, Murat Mehmetit, pas tre muajve punë sistematike, ku është instaluar sistemi i gypave primarë nga puseta kryesore e gypit në fshatin fqinj, Polac, për të vazhduar më pas me instalimin indi-

vidual të shtëpive në rrjetin e ujësjellësit, është finalizuar ky projekt, të cilin e ka mbështet Agjencia e Luksemburgut për Zhvillim Ndërkombëtar - Lux Dev. Mirëpo, në sistemin e ujësjellësit nuk janë kyçur edhe dy lagje të fshatit Kryeshëfc për shkak të buxhetit të limituar,

por edhe për shkak të konfiguracionit të lagjeve. Megjithatë, mbetet që në një të ardhme shumë të afërt edhe këto dy lagje të përfshihen plotësisht në rrjetin e ujësjellësit, pasi mundësia për kyçje tani është më e lehtë me sistemin e instaluar të ujësjellësit në fshat.





# Deri në 36 muaj trajtimi i rasteve të bizneseve në Gjykatën Themelore në Prishtinë

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 31 GUSHT** - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, gjatë një diskutimi me temë "Intervistë me gjyqësorin: Sundimi i ligjit nga perspektiva e sektorit privat", ka shprehur shqetësimin lidhur me trajtimin e kontesteve biznesore në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Ai ka thënë se Departamentit për Çështje Ekonomike në Gjykatën Themelore në Prishtinë i janë dashur 36 muaj për të trajtuar një rast të bizneseve. "Mbi 45 për qind e responentëve që i janë drejtuar Departamentit Ekonomik të Gjykatës Themelore në Prishtinë thonë se zgjatja e rastit të tyre ka zgjatur për më shumë se 36 muaj, ngjashëm qëndron përqindja e responentëve që kanë pasur raste të paraqitura pranë Departamentit Administrativ të kësaj gjykate. Shqetësues është fakti se mbi 90 për qind e bizneseve të anketuara kanë deklaruar se asnjëherë nuk u janë drejtuar mekanizmave për zgjidhje alternative të mosmar-

rëveshjeve, siç janë arbitrazhi dhe ndërmjetësimi", ka thënë ministri Tahiri.

Sipas tij, deri më tani Ministria e Drejtësisë ka bërë një sërë reformash.

Tahiri ka veçuar themelimin e profesioneve të lira ligjore gjë që, sipas tij, kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes. Ministri Tahiri ka shtuar se prioriteti i tij si ministër i Drejtësisë për këtë vit është rishikimi i sektorit të sundimit të ligjit. Ai ka treguar se vëmendje të veçantë po i kushtohet drejtësisë komerciale dhe sektorit të të bërit biznes.

Kurse kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nehat Idrizi, ka thënë se nevojitet një sistem i gjykatave dhe mekanizmave të tjerë të zbatimit të ligjit, i cili do të shërbejë si garantues për mbrojtjen e investimeve dhe operimin e bizneseve në mënyrë të barabartë. "Kosova, sipas përcaktimit të vet kushtetues, ka përvetësuar një model të qeverisjes ekonomike që është ekonomi e tregut të lirë, ku sektorët ekonomikë ndërveprojnë sipas



rregullave të përcaktuara nga tregu, kurse intervenimi rregullator i shtetit është minimalist", ka deklaruar Idrizi.

Alison Storsve nga Zyra Politike dhe Ekonomike e Ambasadës së ShBA-së në Prishtinë ka thënë se sundimi i ligjit duhet të ndodhë në mënyrë që të krijohet mjedisi i mirë i të bërit biznes. Ndërsa drejtori i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, ka thënë

se rritja e efikasitetit është jetike për çrrënjosjen e korrupsionit në Kosovë. "Ky është një aktivitet vjetor i Odës Ekonomike Amerikane i cili synon të sjellë një formë diskutimi me përfaqësuesit e sektorit privat, drejtuesit e institucioneve të drejtësisë, përfaqësuesit e organizatave donatore, në këtë rast të Ambasadës Amerikane dhe USAID-it, të cilët kanë investuar dhe mbështetur

përpjekjen për fuqizimin e sundimit të ligjit, rritjen e efikasitetit, efikasitetin e sistemit gjyqësor, përmirësimin e zbatueshmërisë të kontratave si dhe krijimin dhe fuqizimin e mekanizmave alternativë për zgjidhjen e kontesteve", ka thënë Zeka, duke shtuar se në Odën Amerikane besojnë fuqishëm se ky dialog dhe bashkëpunim duhet të vazhdojë edhe më tej.

## AKP-ja miraton listën për shitjen e 42 aseteve

**PRISHTINË, 31 GUSHT** - Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka mbajtur mbledhjen e rregullt të radhës në të cilën ka shqyrtuar dhe miratuar raportin e shpërndarjes së përkohshme për kreditorët e NSH Semafori (në likuidim). Veç kësaj, Bordi ka miratuar edhe azhurnimin e raportit të shpërndarjes së përkohshme për NSH PMN Sharr në likuidim. Në këtë takim Bordi i AKP-së ka shqyrtuar dhe miratuar listën e valës së shitjes së aseteve me likuidim 42, valë kjo që përfshin asete atraktive në Kosovë, të cilat paraqesin një mundësi të shkëlqyer për investitorët potencialë që kanë interesim për zgjerim të biznesit apo iniciativa të reja biznesore në Kosovë si



dhe raportet e komisioneve për përcaktimin dhe vlerësimin e çmimeve të tregut për qiradhënie

të aseteve të NSH-ve. Gjatë kësaj mbledhjeje Bordi aprovoi edhe raportet e komi-

sionit për shqyrtim të ankesave për 20 për qind të punëtorëve për tri ndërmarrje shoqërore:

NSH Kosovarja - Artizanati, NSH Luboteni dhe NSH KB Gillogovci. Po ashtu, Bordi i AKP-së ka miratuar raportet rekomanduese të komisionit për shqyrtimin e aseteve me karakter specifik, Bordi në këtë takim u informua dhe miratoi raportin përfundimtar për transferim të pronës shoqërore përmes negociimit për rastin Nr. Ref. BD-96/20 për ngastrën kadastrale nr. 4597/2 me sipërfaqe prej 260m<sup>2</sup>, ZK Gjilan, pronë e identifikuar në emër të NSH "Kualiteti" në Gjilan, si dhe raportin përfundimtar për transformimin e pronës shoqërore përmes negociimit për rastin Nr. Ref. BD-101/12, parcela kadastrale 382-0, ZK Hajvali, KK Prishtinë, pronë e KBI Kosova Export.

## Task Forcë për sigurinë e trafikut rrugor

**PRISHTINË, 31 GUSHT** - Ministri i Infrastrukturrës, Pal Lekaj, të premtën ka nënshkruar vendimin për themelimin e njësitit të Task Forcës për sigurinë e trafikut rrugor. Ky njësit ka për qëllim mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e të gjitha rrugëve publike, mbikëqyrjen dhe kontrollin e transportit rrugor, të udhëtarëve, mallrave dhe transportit tokësor të mallrave të rrezikshme, mbikëqyrjen e sigurisë rrugore në pajtim me rregullat e trafikut rrugor dhe kontrolli i punës së

Qendrave të Kontrollimit Teknik të Automjeteve.

Njësitit udhëhiqet nga zëvendësiministri i MI-së, Idriz Selimaj, dhe përbëhet nga zyrtarë dhe ekspertë të fushave përkatëse, me qëllim të efikasitetit më të madh në përmbushje të misionit, Task Forca do të bashkëpunojë me Inspektoratin e MI-së, Policinë e Kosovës dhe zyrtarë të ministrive të tjera. Këta do t'i përpilojnë edhe propozimet me masat konkrete, të nevojshme për rritjen e sigurisë në trafik.





# LAJM PËR 1 PRILL, BASHA E LUFTON KORRUPSIONIN, THAÇI E BASHKON LUGINËN E PRESHEVËS!



**Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA**

**Korrigjim, ndarje, shkëputje, aneksim apo orgji mashtruese:** Ata që nuk kanë krahë ose përkrahje nuk shtrojnë kushte por pranojnë çdo kusht. Të tillët, për shkak të impotencës politike dhe vendimmarrëse dhe injorancës intelektuale ndërtojnë partneritet të "përrjetshëm" me të fortit sikur që politikanët tanë, kryesisht për ta mbajtur pushtetin thirren në partneritet, besnikëri dhe dashuri të përrjetshme me Amerikën, shtet që vranë e kthjell në tërë botën. Realisht partneritet, besnikëri dhe dashuri nuk mund të garantoni se do ta keni përrjetësisht as me gruan, fëmijët dhe më të dashurit tuaj e lëre më me dikë që përkrahjen e lidhë ekskluzivisht me interesa politike, materiale, strategjike etj. Përkrahja, thuaja në të gjitha rastet shkon drejt të fortit dhe kjo përkrahje vërehet edhe te pleqnarët që ndajnë drejtësi sipas kanunit, e përmendin të dobët kurse e përkrahin të fortin. Ne ia kemi krisur gjumit, hajnisë, falsifikimeve, luftës për pushtet që nuk e kemi, dallaveve të të gjitha llojeve me shpresë se Amerikën do ta përdorim si faturë për të gjitha këto. Jemi thirrur se kemi partneritet me NATO-n me të cilën e kemi fituar luftën e fundit kurse nuk kemi ushtri as me i tremë qentë e mëhallës. Ne duam të integrohem në BE kur ata më parë i kanë liberalizuar vizat për Kolumbinë se për Kosovën. Ne duam të bëhemi anëtarë të Interpolit kur ata, me kërkesë të Serbisë i arrestojnë, që nga presidenti e deri edhe Jahushin e Kodralive, bari delesh. Ne duam të bëhemi përfitues të granteve për zhvillim kurse këta që duhet të na ndihmojnë na i marrin paratë e trustit dhe privatizimit, i qesin në tregun financiar botërorë me kamatë 0.5% kurse neve na ndajnë kredi me 10-25% kamatë. Në vendin e tyre arrestojnë presidentë dhe ministra për korrupsion dhe krim të organizuar kurse te ne vjedhin bashkë me pushtetarët tanë. Për një cm. të

rrezikuar të interesave të tyre intervenojnë në skaje të botës kurse neve nuk na lejojnë ta mbrojmë integritetin territorial dhe ta shtrijmë sovranitetin në sè paku 35% të territorit tonë të okupuar dhe kontrolluar nga Serbia. Për një qytetar të zhdukur apo arrestuar në ndonjë shtet tjetër, e dridhin shtetin me sanksione ekonomike dhe politike. Për 12,000 të vrarë dhe 1600 të zhdukur në Kosovë kërkojnë të jemi tolerant, të falim dhe të pajtohemi, pa u përballur me ligjin ata që bënë krime. Se sa është e përrjetshme përkrahja, dashuria dhe partneriteti me një shtet e kemi shembujt e fundit kur z. Bolton, këshilltar për siguri i presidentit Trump haptazi përkrahë ndryshimin e kufijve dhe territoreve dhe, në të njëjtën kohë i kërcënon vendet tjera se nuk duhet ta pengojnë këtë proces. Kaq u desh që të hapet kutia e Pandorës (Mihrisë) dhe të dalin të gjitha gjërat e liga që, zoti i krejt zotave Zeusi i pati mbyllur në kutinë e Pandorës kurse Boltoni po e hapë sikur që edhe Hashim Thaçi po e hapë kutinë e Mihrisë (varianti kosovar i kutive së Pandorës) nga po dalin të këqijtë dhe të ligët si Pacolli, Çollaku, Batoni, si ekzemplarë të së keqes dhe disa buburreca të mjerë. Pastaj, një dyfytirësh dhe injorant sikur puna e Johaneshann del dhe publikisht thotë se; BE e përkrahë ndryshimin e kufijve dhe territorit me një kusht që kjo nuk vlen për shtetet dhe vendet tjera por vetëm për Kosovën. Me një fjalë, me gërshtë mund ta masakroni territorin e Kosovës duke e forcuar Serbinë por jo që shqiptarët e Maqedonisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë t'i bashkohen Shqipërisë. Ai, Hani dhe Boltoni po mendojnë se të gjithë shqiptarët dukemi, mendojmë, sillemi, veprojmë sikur Hashim Thaçi dhe se të gjithë e kemi formatin e prapanicës sikur të Hashimit dhe kondomëve që shkojnë pas tij. Nëse i merrni gërshtë atëherë po i hyjmë të gjitha vendeve në Ballkan dhe po e kthejmë Serbinë në pashalëkun e Beogradit, po e kthejmë Artën, Prevezën, Janinën dhe Çamërinë, po ia lëmë Maqedonisë manastirin Prohor Pčinjski sepse territoret tjera ishin shqiptare, po e marrim tokën që dhunshëm na e morën knjazët e Crna Gorës me esadistët e toptanëve etj. etj. Po e shihni lexues të nderuar se në këtë kontekst Hashim Thaçi është

shumë më modest se unë, edhe në mashtrim, ai po e premtonte vetëm Luginën e Preshevës kurse unë ua premtoj 80% të Ballkanit. **Pse ndodhi kjo:** E kemi një situatë, sa interesante aq edhe të rrezikshme që ma kujton historinë e Spartës. Shkaku i dashurisë ndaj Helenës u bë një luftë e tmerrshme dhe u shkatërrua një civilizim. Edhe këtu, në Kosovë shkaku i dashurisë ndaj përkthyeses së Daçiqit apo Vuçiqit, Thaçi po i krijon të gjitha kushtet të bëjmë një luftë tjetër. Realisht, kurrë nuk ka qenë më lehtë që politikisht dhe në planin diplomatik të mbrohet vendi ynë. Thjesht, Kosova, si njësi konstitutive e federatës së ish Jugosllavisë, i kishte kufijtë e përcaktuar dhe të pranuar. Po me këta kufij e shpalli pavarësinë të cilën e pranuan më shumë se 100 shtete sikur që as Gjykata Ndërkombëtare e Hagës nuk e kundërshtoi këtë. Këta kufij i legjitimoi edhe kriminelin kushtetues dhe juridik, Mati Ahtisari kurse tash Hashimi i ka vënë në tender njëburimorë ku fiton vetëm njëra palë, ajo është Serbia kriminale dhe fashiste. Për këtë ka siguruar përkrahjen e keqbërësve dhe atyre, që, nëse ia shihni trungun gjenealogjik, në 500 vitet e fundit, asgjë të hajrit nuk kanë bërë për popullin shqiptar dhe për këtë vend. Përkundrazi, kryesisht i kanë dëmtuar këto interesa. Nuk mund të mohohet e kaluara dhe kontributi kombëtar i Hashim Thaçit por çfarë të kaluarë kanë këto patericat e Hashimit, të cilët as Azem Vllasi nuk do t'i merrte si shoqërues në mitingun e Gazimestanit kur Millosheviqi e nisi vallen e kimit dhe kur Azemi me të tjerët i lëshuan gaçet para Millosheviqit. Thënë të drejtën, po më brengosë, në aspektin shëndetësorë këmbëngulja e Hashimit që të na bind se e ka vendosur t'ia bashkangjes Luginën e Preshevës Kosovës kurse Serbisë, si kompensim ia ofron leshin e Marisë. Këta të Luginës, disa prej tyre, mashtrues si veteranët e rrejshëm, po e përkrahin "idenë gjeniale" të Hashimit dhe, çuditërisht kanë filluar të besojnë këtë! Ata që nuk janë leshko politikë dhe mashtrues ordinerë, këtë "luftë" të Hashimit po e vlerësojnë sikur edhe që unë e them, është top lajm për Festën e 1 Prillit, Ditën Ndërkombëtare të atyre që e flasin të vërtetën dhe vetëm të vërtetën. E keni parë që

edhe paterica permanente, Bekim Çollaku, po deklarohet edhe për medie ndërkombëtare për "idenë gjeniale" të Hashimit, për korrigjimin e kufijve. Batoni, si patericë kujdestare e që i përshtatet të gjitha politikave, e lëshoi pordhën provuese në gazetën Mapo pasi i lagën brekët dhe e mbushën cullën në jahtin e kartagjenasit Behgjet Pacolli, së bashku me Hashimin. Madje, edhe disa fundamentalistë të injorancës e që për fat të keq janë edhe këshilltarë të Kadri Veselit, disi, sikur Çollaku dhe Batoni po i lejojnë veti që, me "kompetencë" të flasin për korrigjimin e kufijve. Të gjithë po e kundërshtojnë "idenë gjeniale" të Hashim Thaçit, sikur nga radhët e pozitës, ashtu edhe të opozitës. Në përkrahje të Hashimit ka mbetur qyqe vetëm, PDK-ja, parti ku Hashimi është aksionari kryesor kurse Kadrisë i shkojnë faturat e dështimit. Mendoj që partia e parë që do të duhej ta kundërshtonte këtë ide do të duhej të ishte pikërisht PDK-ja dhe, në veçanti kam prituri që Kadri Veseli do të reagojë i pari dhe nuk do të pranonë asnjë kompromis për kufij dhe territore. Kadriu e ka të qartë se kurrë Serbia nuk do të heqë dorë nga Lugina e Preshevës, as me çmim të një lufte tjetër. Nëse Hashimi dhe PDK-ja pajtohen që ta këmbëjnë Terrnovcin e Bujanoci, me Ujmanin dhe Treççën, le të urdhërojnë. Por jam i sigurt se këtu nuk do të ndodhë, as lëvizja e kufijve e as këmbimi i territoreve sepse Serbia e ka për synim autonominë politike, ekonomike dhe territoriale për serbët e Kosovës e që do të krijohej një mekanizëm i përhershëm destabilizues, Asociacioni i komunave serbe dhe i cili, për aktivitetet destabilizuese do të financohet nga Buxheti i Kosovës, sikur Lista serbe dhe bashkësia ndërkombëtare. Por, në variantin më të keq, nëse gjeodeti Thaçi ia jep fletën poseduese të një pjese të Kosovës Aleksandar Vuçiqit, atëherë, me një procedurë të përsheptuar do ta kemi një bashkim me Shqipërinë, si mbetje mortore të një shteti që po e shkatërron vet shqiptarët. Në këto rrethana, qëndrimin më korrekt e ka kryeministri Ramush Haradinaj që po tregohet i palëkundur në kundërshtim të ideve jonormale të Hashimit, nëse del se këto ide janë të vërteta e jo retorikë politike. Jam shumë i sigurt se ndryshimi i

kufijve të Kosovës do të shkaktojë luftë të menjëhershme sikur që jam i sigurt se edhe Asociacioni i komunave serbe në Kosovë, me kompetencë ekzekutive sikur Republika Srpska, nëse jetësohet (ky është qëllimi i Vuçiqit dhe lëshimi eventual i Thaçit), gjithashtu do të sjellë luftë në Kosovë por në një fazë të mëvonshme. Statusin special për serbët në Kosovë në asnjë mënyrë nuk është dashur ta bëjnë kategori kushtetuese por vetëm si diçka kalimtare, për një kohë të caktuar, deri sa të stabilizohet shteti i Kosovës që kurrë nuk do të stabilizohet me këtë konjunkturë kushtetuese dhe me këta "liderë politikë" që i kemi. Kosova nuk duhet të bisedoj për kufij e as për territore sikur që duhet t'ua bëjë të qartë shqiptarëve që jetojnë në shtetet fqinje se ata janë qytetarë të atyre shteteve dhe se Kosova do t'iu dalë në ndihmë për aq sa i lejojnë marrëveshjet dhe dokumentet ndërkombëtare. Po të njëjtin trajtim do të duhej ta kishin edhe serbët dhe pakicat tjera në Kosovë dhe këto të drejta, realizimi apo mosrealizimi i tyre do të monitoroheshin dhe nëse nuk janë në përputhje me dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare, ndaj Kosovës do të ndërmerreshin, me të drejtë, masa përkatese. Kështu, para syve të bashkësisë ndërkombëtare, shqiptarët trajtohen si qytetarë të rendit të dytë apo të tretë kurse të pretendohet se serbët në Kosovë do të duhej trajtuar si "populli hyjnorë", për çfarë të drejta dhe për çfarë morali po flisni!?! Me Serbinë mund t'i normalizojmë marrëdhëniet vetëm nëse ata nuk ndërhyjnë në punët e brendshme të Kosovës, nëse e kalojnë procesin e ballafaqimit me të kaluarën e tyre kriminale, nëse kërkojnë falje qoftë edhe simbolike, nëse tregojnë për fatin e personave të pagjetur, nëse e kthejnë pasurinë e plaçkitur, nëse i kompensojnë dëmet që i kanë bërë në Kosovë dhe nëse i dorëzojnë të dyshuarit për krime lufte dhe të cilët, me të gjitha privilegjet dhe përkujdesje shtetërore janë strehuar në Serbi. Në të kundërtën, duhet t'i fakirizim (shkërdhejmë) takimet e Thaçit me Vuçiqin dhe të bëhemi gati edhe për sakrificën e radhës. Jam i sigurt se rinia nuk do të durojë në pakufi aventurat sentimentale të Thaçit, me Vuçiqin apo të tjerët siç nuk e kanë duruar as robërinë, si në kohën e



mbretërisë jugosllave, në kohën e babait politikë të disa këshilltarëve të Thaçit dhe Veselit, kriminelit Tito e në veçanti të kohës së kriminelit Millosheviq, babait politik të Aleksandar Vuçiqit. Mashtrime të paskrupullta janë se normalizimi i marrëdhënies me Serbinë sigurojnë njohje nga Serbia dhe përshpejtojnë integrimet në BE, NATO dhe në Shoqatën e kurvave politike dhe jopolitike (shoqëria civile) dhe sidomos në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Unë e pranoj se nuk jam fort i mençur prandaj, për ta përmbushur kureshtjen time, ju lutem më tregoni se a besoni ju se Rusia, Kina dhe shumë shtete tjera do të lejojnë që shqiptarët t'i kenë dy vota në OKB dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë ku merren vendime globale?! Kurrë dhe

asnjëherë. Po të flinte Kosova në 30.000 tona të uraniumit apo arit sa vlerësohet se janë veteranë mashtrues, bota do të sillej ndryshe ndaj nesh, ndoshta do të lejonin edhe dy shtete shqiptare! Kështu, shtet me një buxhet social shtetërorë dhe i cili nuk ka rezerva as për një javë për raste emergjente, kush na përkrahë si të tillë?! Vetëm bëjeni një analizë se kush dhe me aq lehtësi bëhet ministër, ambasadorë, kryetar bordi i kompanive të mëdha të cilat i falimentojnë, kush krijon opinion, cila është shtëpia publike informative në Kosovë, kush e përfaqëson Kosovën në vendet tjera dhe do ta kuptoni se punët nuk i kemi edhe aq keq! Shiheni listën e heronjve të Kosovës e që ishin në shërbim të Serbisë dhe do ta kuptoni me të drejtë

degradimin moral që është shndërruar në ndryshk të shtresuar. Shiheni anamnezën "intelektuale" të atyre që edukojnë gjenerata e gjenerata nxënës dhe studentë dhe do ta kuptoni përhapjen aq të madhe të analfabetizimit funksional në Kosovë. Tash, merreni me mend, pas heshtjes të atyre që e kishin detyrim të reagonin menjëherë dhe, ta citojë Hydën, pa ekuivoqe (nuk e kam të qartë kuptimin por po më duket vetja më intelektual kur e them, pa ekuivoqe), si mbrojtës të integritetit territorial të Kosovës dhe sovranitetit po dalin pinjollët e Titos dhe të Millosheviqit që duan ta marrin flamurin e patriotizmit, qoftë duke kundërshtuar ashpër oral (isht), qoftë duke kërcënuar me demonstrata. Pas këtyre prononcimeve ultra patriotike,

besimin se e ka përnjëmend te unë e ka fituar vetëm vëllau i Boro Vukmirovit, Ramizi. Bravo Ramiz, patriot ke qenë dhe patriot do të mbetesh përjetësisht. Deri në Plazma keksin e fundit!

**Diçka për titullin:** Sali Berisha dhe Lulëzim Basha janë thujatë të vetmit në Shqipëri që tërë jetën ia kanë kushtuar luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Sali Berisha, duke ditur se ka ende për të bërë në këtë fushë, edhe pas pensionimit po e vazhdon këtë aktivitet, së bashku me Lulin e Vocërr. Tash po premtojnë se shtatori do të jetë muaji kur do të fitojë demokracia dhe kur Edi Rama do të hidhet në plehra. Disi po e paralajmërojnë Shatorin e Zi sikur në kampet Sabra dhe Shatila kur forcat jordaneze dhe milicit falangiste

ekzekutuan 7-8000 palestinezë. Nëse keni lindur në Kinë (rajone të izoluar, pa mundësi komunikimi) apo në Mongoli, atëherë edhe mund të besoni në fjalët e Lul Bashës dhe Sali Berishës. Mirëpo, nëse i keni kaluar vetëm 30 sekonda në Shqipëri, e keni parë Shqipërinë qoftë edhe nga aeroplani e mos të flasë nëse keni kaluar nëpër Rugën e Kombit, atëherë, pa asnjë hezitim do të bindeni se maja e korrupsionit në Shqipëri janë pikërisht Saliu dhe Luli apo Don Kishoti dhe Rosinanti. Nëse besoni se Sali Berisha dhe Lulëzim Basha e luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar në Shqipëri pse të mos besoni se Hashim Thaçi do t'ia bashkangjesë Luginën e Preshevës Kosovës madje edhe një pjesë të Manxhurisë, në Kinën e largët!

DITARI I PROFESORIT / Në shenjë të 50-vjetorit të demonstratave të vitit 1968

## Nga Fakulteti Filozofik drejt ndërtesës së burgut

Shkruan: Ismail SYLA

- Dy mësimdhënës të mi në Gjimnazin "Skënderbeu" të Gllgovcët

Demonstruesit rirreshtohen para Fakultetit Filozofik. Ndërkaq, demonstrues nga Ferizaj, Llapi dhe Drenica kishin arritur në Prishtinë. "Aty mbretëronte një gjendje manifestimi. Demonstruesit bisedonin e përshëndeteshin, fytyra u qeshte. Ata që sapo arrinin, uronin me fjalët më të mira. Herë pas here nuk dëgjohej asnjë zë në kopsht. Pas fjalëve të njerëzve nga shkallët e Fakultetit mbanin fjalim studentë, nxënës, punëtorë, arsimtarë, të cilët me diskutimet e tre përkrahnin dhe inkurajonin demonstruesit. Aty foli një individ, të cilin e thirrshin Jusuf Gjunduzi nga Presheva, pastaj Adem Rukiqi, i cili i përshëndeti demonstruesit në emër të Drenicës: 'E tërë Drenica është me ju'. Foli edhe një vajzë, nxënëse e Shkollës Normale. Para Fakultetit ishte një atmosferë e këndshme. Ishte pasdite e vonë vjeshte. Kopshti vlonte prej zhurmës, prej brohoritjeve. Dikush uronte, kurse masa përgjigjej: 'Rroftë Adem Demaçi' etj. Për një çast dikush doli në shkallë të Fakultetit dhe lajmëroi se ishin arrestuar shumë demonstrues, në mesin e tyre edhe Fehmi Pushkollli. Profetori Fehmi Pushkollli respektohej shumë nga nxënësit e Shkollës Normale" (f. 98), shkruan profesori Sahit Berisha.

Nga Fakulteti Filozofik masa e revoltuar nis drejt burgut. Në krye të kolonës me flamur prin Mejreme Berisha, motra e autorit të kujtimeve. Autori me detaje bën përshkrimin e lëvizjes së demonstruesve, pozicionin e ushtarëve. Në një çast, te kthesa e fundit që çonte drejt burgut, kordoni i policëve të armatosur hedh breshëri mbi demonstruesit. Autori Berisha është dëshmi-

tar i rënies heroike përballë policëve të dëshmorit të parë të demonstratës së 27 nëntorit 1968, Murat Mehmeti. Krahas tij plagoset flamurtarja, motra e Sahitit, Mejreme Berisha. Në kolonën e dytë të demonstruesve nga të shtënat e ushtarëve plagoset normalisti Sylejman Kastrati i klasës së katër/gjashtë (f. 101). Po ashtu autori që kishte pësuar nga një goditje e rëndë në këmbë, në një moment rrethohet nga disa policë të cilët e godasin me shqelma dhe shufra gome. Por, falë turmës së guximshme, lirohet nga duart e tyre (f. 103). Një agresivitet të llojit të veçantë mbi demonstruesit kishin treguar banorët serbë në ndërtesa buzë shesheve dhe rrugëve kryesore, siç dokumenton autori: "Derisa kolona ecte rrugës, në drejtim të veriut, nga dritaret e ndërtesave të afërta serbët qëllonin me gjëra të ndryshme: me vazo të luleve, tjegulla e me ujë të vluar" (f. 104). Rreth orës 22 në Prishtinë kishin arritur njësi të policisë nga Serbia. Kishte përpjekje për t'i rrethuar demonstruesit. Me fjalën e profesorit Mark Krasniq, dhe me kërkesë e akordim që të nesërmen, më 28 nëntor të mbledheshin demonstruesit për varrimin e Mumrat Mehmetit, fillon edhe shpërndarja e demonstruesve.

Një kapitull më vete është vajta në spital e të plagosurve dhe të lënduarve. Aty mjekët serbë e dëshmojnë shpirtin e tyre aspak human. Përkundër betimit të Hipokratit, secili i plagosur për ta është armik i shtetit, është nacionalist. Autori tregon deri në detaje keqtrajtimin në spital të nxënësit të plagosur Sylejman Kastrati me origjinë nga Kizhareka e Drenasit (ish Gllgovci).

**Një debat i ashpër me elitën komuniste krahinore**

Më 3 dhe 4 dhjetor 1968 pati dy zhvillime interesante nga



nxënësit e Normales. Një tentativë për të demonstruar në qytet e preventojnë profesorët e Normales me premtimin që kërkesat e studentëve do të shqyrtohen në sallën e shfaqjeve të shkollës. Në tubimin e 3 dhjetorit ka diçka vërtet dramatike. Për vendosmërinë e dhe guximin e profesorit Sahit Berisha, atëherë si normalist, më kishte folur para disa muajsh një mësues i respektuar, Hestet Çelaj nga Kizhareka. Nga shënimet e kujtimeve e gjeta për cilin moment kishte folur z. Çelaj. Është pikërisht ai ku ballë përballë janë nxënësit atdhetarë me përfaqësuesit e pushtetit jugosllav, të kryesuar nga Xhavit Nimani, Salih Nushi, Kemajl Deva dhe Ilija Vukiqi (f. 125).

Autori sjell vlerësimet autentike që udhëheqja e Kosovës kishte bërë kundër demonstratave të 1968-ës. Në një moment të krijohet ndjenja e ndeshjes midis heronjve (nxënësve) antiheronjve (pushtetarëve) dhe në rolin e protagonistëve të tretë, një lloj specie neutralësh sa për sy e faqe, por që shpirtërisht dhe me ide ishin me nxënësit e tyre, profesorët e tyre, pëshpëritësit, suflerët, siç i quan profesori Sahit Berisha. Në një moment ekspozonë e ideve dhe kërkesave të nxënësve e paraqet normalisti i guximshëm, autori i ditarit

Sahit Berisha.

Po ashtu, në tekstin e kujtimeve autori tregon se si vendosmëria dhe solidarizimi i fuqishëm i normalistëve me bashkëmoshatarin e tyre bën që nxënësit Bedri Jusufi dhe Sadik Osmani të lirohen nga burgu më 4 dhjetor 1968. Ata qenë dënuar me procedurë të shpejtë (f. 112).

**Si përfundim**

Para takimit të orës 9 të 28 gushtit 2018 në kafe restorantin "Union" afër Teatrit Kombëtar, me profesorin Sahit bëjmë një foto te monumenti i Skënderbeut në shesh. Fotoja, pa pikë përtese "shkrepet" nga një kalimtar i rastit. Profetori ka veshur një komplet me ngjyra verore dhe ka mbërthyer kravatën. Temperatura është jo lartë, si një fillim vjeshte. Ulemi në tavolinën me dy karrige, brenda në "Union". Pas diskutimit për strukturën e ditarit, profesori i bën rezime vitit 1968. Ritregon rëndësinë e krenimit të 500 vjetorit të Skënderbeut në Prishtinë. Atyre ditëve, thotë ai, qendra e Prishtinës vlonte nga njerëzit që kishin dëshirë të takohen me ndonjë nga pjesëmarrësit e Shqipërisë në konferencë. Qoftë edhe ndonjë shofer apo kushdo tjetër për ne ishte i rëndësishëm, thotë profesori. Edhe ata, sigur-

isht me parapërgatitje, nuk ishin duarthatë. Kishin me vete distinktivë me figurë e Skënderbeut, harta të betejave përgjatë 25 vjetëve rezistencë të Gjergj Kastriotit. Kështu, dita ditës mbytej frika. Një frymë unifikimi shpirtëror vërehej gjithnjë e më shumë... Dhe nga kjo temë, kalohet te rezistenca e Rifat Berishës dhe të tjerëve, një histori shumë e pasur për ndonjë shkrim tjetër.

**BIOGRAFIA**

Sahit Berisha u lind më 28.09.1947 në fshatin Leletiq, Komuna e Lipjanit. Familja e tij në këtë fshat erdhën nga fshati Berishë, Komuna e Malishevës. Tash jeton në Prishtinë. Shkollën fillore, ciklin i ulët e kreu në qytezën Magurë, kurse ciklin e lartë e përfundoi në Shkollën Fillore "Emin Duraku" në Prishtinë. Kreu Shkollën Normale "Miladin Popoviq" në Prishtinë. U punësua për herë të parë në vitin shkollor 1970/71 si mësues në Shkollën Fillore "Stanko Buriq" në Magurë. Pas kërcënimit me burgim nga kryetari i Komitetit Komunal të LKJ-së të Lipjanit, si dhe organeve të tjera, si antijugosllav ai largohet nga puna dhe merret në bisedë informative nga organet e sigurimit. Në vitin 1975 u punësua profesor i historisë në Shkollën Mesme "Skënderbeu" në Gllgovc. Më 1976 arrestohet në hallin sportive "25 Maji" sot "1 Tetori", ku zhvillohej ndeshja sportive në voleyboll, në mes të reprezentacionit të Shqipërisë dhe të Jugosllavisë. Më 16. IV. 1981 burgoset nga sigurimi i Gllgovc (Drenasit). U larguar nga puna si i papërshtatshëm ideo politikisht dhe si antijugosllav. Më 10. VIII 1991 u burgos përsëri nga organet e sigurimit serb në Gjilan. Më 23. V. 1992 arrestohet nga Sigurimi Shtetëror në Prishtinë. Në mars të vitit 1993 punësohet në gjimnazin "Xhevdet Doda" në Prishtinë, si profesor i historisë. Tash është pensionist. (Fund)



**E rrallë**

## Spanjë, "luftë e përgjakshme" me domate

Duket si një betejë e përgjakshme mes të rinjve, por është thjesht një festival që ka të bëjë me një "luftë" me domate. Bëhet fjalë për festivalin "La Tomatina", i

cili zhvillohet në qytezën e vogël Bunjol, pak kilometra larg Valencias, në Spanjë. Më shumë se 22 mijë veta mbuluan me domate qytezën, në atë që



konsiderohet beteja më e famshme në botë.

## BARSOLETA E DITËS



Hyn një person në farmaci dhe e pyet farmacistin: Zonjë, keni diçka kundër kollitjes? Farmacistja i përgjigjet: Jo, lirisht mund të kolliteni, nuk kam asgjë kundër!



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

#### "INCREDIBLES 2" 3D


I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird



### FOTO E DITES



Monkejet bredhin rreth 272 shkallëve të pikturuara në tempullin e Maleve të Batu Caves në Kuala Lumpur. /AFP/

Në ora 18:20

#### "FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco



Në ora 20:00

#### "ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed




Në ora 22:00

#### "LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

### E jashtëzakonshme

## Kinezi ia del të garojë me biçikletë në Everest

Ngjitja e Everestit është një sfidë e stërlodhshme edhe për alpinistët më të përgatitur të botës, që e konsiderojnë si "Mekën" e kalendarëve të tyre të alpinizmit. Por, të garosh mbi pedalet e një biçiklete në malin më të lartë të botës, me 8 848 metra mbi nivelin e detit, është diçka në kufijtë e të



paarritshmes. Në fakt, JJ Zhou nga Kina sapo është bërë personi i parë që e bën realitet këtë sfidë thujse të pamundur.



#### DASHI

Perceptimi juaj se dikush ju ka mashtruar

në një çështje pune do të rezultojë i vërtetë.



#### DEMI

Po ndiqni një informacion të dhënë

nga një person që nuk e njihni dhe aq mirë. Do të rezultojë i saktë.



#### BINJAKËT

Gjërat janë ashtu siç keni pritur

dhe kjo gjë ju ka sjellë një lloj relaksi që po ju pëlqen.



#### GAFORRJA

Jeta sentimentale është në kulmin e

saj dhe po prisni ta finalizoni me diçka më të rëndësishme.



#### LUANI

Shoqëria e mirë dhe miqtë do të jenë

ata që sot do të përkujdesen për t'ju bërë qejfin. Ndiheni mjaft të përkëdhelur.



#### VIRGJËRESHA

Partneri ka vendosur t'ju japë

një lajm surprizë. Nuk do ta prisni aq mirë sa mendohej.



#### PESHORJA

Nëse keni marrë vendime që s'i keni konsultuar më parë më të tjerët, duhet t'i merrni përsipër dhe përgjegjësitë nëse rezultojnë të gabuara.



#### AKREPI

Jeni mjaft të favorizuar nga yjet sot

dhe çdo iniciativë e juaja do të vlerësohet. Merrni më seriozisht lidhjen sentimentale.



#### SHIGJETARI

Jeni karaktere impulsive dhe sot do

ta vërtetoni këtë gjë. Një situatë stresante do të komplikohet më shume nga ju.



#### BRICJAPI

Natyrë juaj e qetë ka bërë që

persona rreth jush të fillojnë të tregohen më tolerantë.



#### UJORI

Shpirti liberal dhe

aventuresk do të triumfojë sot dhe ju do të jeni të rrethuar me persona që duan të provojnë të njëjtat përvoja.



#### PESHQIT

Keni kompensuar kohën e humbur

dhe sot do të jeni pranë personave që ju duan. Po e shijoni çdo çast.



# PROMOVIM



## ÇËSHTJA SHQIPTARE PËRBALL DIPLOMACISË DHE GJEOPOLITIKËS RUSO-MADHE 1856-2018

Mr. sci. Hamz S. Lladrovci

Promovimi i librit mbahet më:

**01.09.2018** (e shtunë)

në orën **12:00** në

**Hotel Grand** në Prishtinë, **(Salla solemne)**



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BIRMINGHAM - QUEENS PARK

1

ABERDEEN - KILMARNOCK

1

ARMINIA BIELEFE - REGENSBURG

1

## Feronikeli kërkon maksimumin ndaj Ballkanit

Feronikeli po kërkon me çdo kusht fitoren në ndeshjen ndaj Ballkanit nga Suhareka. Kastriot Rexha ka thënë për "Epokën e re" se është momenti i fundit që "Nikli" t'i arkëtojë pikët e plota, kurse Besnik Krasniqi nga skuadra e Ballkanit është optimist se nga Drenasi skuadra e tij do të rikthehet e pamposhtur



në këtë ndeshje të luajmë lojë sa më të mirë dhe të përpiqemi të marrim rezultat sa më të favorshëm. Feronikeli ka skuadër të fortë me futbollistë cilësorë dhe në këtë ndeshje është favorit, por duke parë formën jo të mirë të tij, do të përpiqemi të nxjerrim barazim, pse jo edhe fitore", ka thënë Krasniqi.

Të dyja skuadrat, Feronikeli dhe Ballkani, nuk kanë asnjë mungesë për ndeshjen që zhvillohet në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas. Mbrojtësi

Krasniqi në të kaluarën ka luajtur me plot sukses për skuadrën e Feronikelit, kurse tash është një nga pikat më të forta në skuadrën e Ballkanit. Sot (e shtunë) zhvillohet edhe ndeshja tjetër në mes të Llapit dhe Ferizajt.

### Drita humbet edhe nga Liria

Kampionia në fuqi e IPKO Superligës, Drita, ka regjistruar edhe një tjetër humbje. Skuadra

IPKO Superliga - Java e tretë

Liria-Drita 3-2  
Të shtunën takohen:  
Feronikeli-Ballkani  
Llapi-Ferizaj

Të dielën takohen:  
Flamurtari-KEK-u  
Gjilani-Trepça '89  
Prishtina-Drenica

gjilanasë, pas humbjes nga Flamurtari, pësoi humbje sot edhe nga Liria e Prizrenit (3-2). Pas tridhjetë minutave lojë, Xhevdet Shabani e solli Dritën në epërsi, por në fund të pjesës së parë shifrat në 1-1 i barazoi Qëndrim Gashi. Xhevdet Shabani (55) sërish e kaloi Dritën në epërsi 1-2, por futbollisti i rikthyer te Liria, Liridon Fetahaj (65), e barazoi rezultatin në 2-2. Fetahaj e realizoi në minutën e 73-të golin e tretë dhe të fitores për skuadrën nga Prizreni.

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 31 GUSHT - KF Feronikeli kërkon maksimumin e pikëve në ndeshjen e tretë të këtij edicioni ndaj Ballkanit, e cila zhvillohet sot në Drenas. Kastriot Rexha ka thënë se skuadra e "Niklit" është përgatitur maksimalisht për ta shënuar fitoren e parë në këtë edicion garash në elitën e futbollit të Kosovës. "Të them drejtën kemi një panik të vogël në klub pas dy barazimeve në ndeshjet e para, por edhe fati nuk ishte në anën tonë. Ne jemi përgatitur mirë për këtë ndeshje dhe kërkojmë dhe synimi i vetëm janë tri pikët, çdo rezultat tjetër, përveç fitores,

është dëshpërim për Feronikelin", ka thënë Rexha, i cili ende nuk e ka shijuar golin me fanellën e skuadrës së Feronikelit. "Si çdo sulmues, edhe unë e kam për detyrë të shënoj, por në dy ndeshjet e para nuk arrita të bëj një gjë të tillë. Kam besim se në ndeshjen ndaj Ballkanit do të shënoj dhe do t'i regjistrojmë fitoret radhazi", ka deklaruar Rexha.

Ky i fundit ishte sulmuesi kryesor i Dritës në edicionin e kaluar, kur kjo skuadër arriti ta fitojë titullin e kampiones. Rezultat të favorshëm kërkon edhe skuadra e Ballkanit, ani pse Besnik Krasniqi e pranon se favorit absolut në këtë përballje është skuadra e Feronikelit. "Synimi ynë është që

## Greza: Transferimi te Rangersi, hap i madh në karrierën time

Reprezentuesi i Shqipërisë, Eros Grezda, e ka bërë edhe një hap tjetër të madh në karrierë, pasi ka nënshkruar kontratë katërvjeçare me skuadrën e Rangersit në Skoci. Anësori kuqezi në të kaluarën ka luajtur për Osijekun dhe Lokomotivën e Zagrebit

**EPOKA E RE** Liridon ZEQRIRI

PRISHTINË, 31 GUSHT - Ashtu siç raportoi ditë më parë "Epoka e re", se Eros Grezda do të jetë futbollist i Rangersit, ashtu ndodhi. Në fakt, shqiptari është prezantuar të premtën të skuadra skoceze, kurse ka nënshkruar kontratë katërvjeçare. "Futboll Klub Rangers konfirmon nënshkrimin me shqiptarin Eros Grezda. Ai ka nënshkruar një kontratë

katërvjeçare, me kusht që të marrë vizë dhe leje ndërkombëtare. Anësori 23-vjeçar nga Gjakova e ka filluar karrierën me klubin e Aluminij në Slloveni e më pas ka luajtur për Zavrç. Më pas ka kaluar në Kroaci te Lokomotiva për të vijuar me Osijek, që ishte klubi nga po transferohet futbollisti", thuhet në njoftimin e klubit. Ndërsa si futbollist i skuadrës së Rangersit ka folur edhe Eros Grezda. Ai ndihet shumë i lumtur që është bërë pjesë e kësaj



skuadre me histori të madhe. "Kam ëndërruar që fëmijë që të luaj me një klub të madh, i mbështetur nga shumë tifozë. Pres me padurim të luaj para tifozëve. Mendoj se ishte koha e duhur për mua, që në moshën

23-vjeçare të kalojë në një ligë kaq të mirë dhe në një klub të madh si Rangersi. Ky është një hap i madh në karrierën time. Pres me padurim të luaj ndeshje zyrtare me tifozët. Klubi dhe tifozët presin shumë që unë të jap mak-

simumin. Unë jam lojtar i shpejtë dhe unë do të mendohej të shënoj gola", ka thënë Grezda. Reprerentuesi i Shqipërisë, Eros Grezda, bëhet futbollisti i 14 i transferuar nga Stiven Gerrard. Legjenda e Liverpoolit e ka lavdëruar futbollistin nga Gjakova, duke thënë se do t'i ndihmojë shumë skuadrës së tij. "Grezda ishte lojtar i shkëlqyer edhe tek Osijeku. Ai ishte më i miri i skuadrës. Grezda është lojtar shumë i mirë dhe i rrezikshëm. Megjithatë nuk duhet thënë për askënd që më vjen mirë që është dëmtuar, unë falënderoj zotin që Grezda ishte i dëmtuar dhe nuk luajti kundër nesh në Evropë", kishte deklaruar Gerrardi.

## Maqedonia - Kosova përfundon pa fitues

PRISHTINË, 31 GUSHT - Tri shtylla e një goli i anuluar është bilanci i ndeshjes së parë të Përfaqësues A të femrave kundër kombëtares së Maqedonisë. Ndeshja u karakterizua me një lojë mesatare nga të dyja palët ani pse Kosova pati diçka më shumë nga loja.

Krijoi disa raste shënimi, ndërsa futbollistet e Kosovës goditën tri herë shtyllën dhe një gol i anulua me arsyen e pozitës jashtë lojës që për shumikënd ishte e dyshimtë. Edhe ekipi i Maqedonisë pati një pingule dhe disa gjysmë raste, por jo më

shumë. Ndeshja e dytë do të zhvillohet më 2 shtator. "Mendoj se luajtëm mirë, patëm disa raste shënimi, por duket se në këtë ndeshje fati ishte kundër nesh. Besoj se në ndeshjen e dytë do të arrijmë sukses", ka thënë Edona Kryeziu, kapitene e Kosovës.





## Ajeti zgjedh Zvicrën

CYRIH, 31 GUSHT - Zvicra ka publikuar listën e të ftuarve për dy ndeshjet e shtatorit në Ligën e Kombeve dhe kësaj liste i është

shtuar edhe një tjetër futbollist shqiptar. Bëhet fjalë për sulmuesin Alban Ajeti, që ka refuzuar Kosovën e Shqipërinë,

për t'u bashkuar me kombëtaren e Zvicrës. Ajeti u shtohet shqiptarëve të tjerë që luajnë për Zvicrën: Granit Xhaka,

Xherdan Shaqiri dhe Admir Mehmedi. Zvicra e kishte lënë jashtë listës Alban Ajetin për Botërorin Rusia 2018.



## Milani, Arsenali dhe Chelsea mësojnë kundërshtarët në Evropa Ligë

MONACO, 31 GUSHT - Në Monaco është hedhur shorti i fazës me grupe të Evropa Ligës për edicionin 2018/2019. 48 skuadra janë ndarë në 12 grupe, nga ku kualifikohen dy vendet e para. Këtyre 24 ekipeve i bashkohen 8 vendet e treta në grupet e Ligës së Kampionëve, kur fillon raundi i 1/16-ve të finaleve, me eliminim të drejtpërdrejtë, në muajin shkurt 2019. Milani, shtatë herë fitues i Ligës së Kampionëve, do të ketë një grup relativisht të ekuilibruar me grekët e Olympiacosit,



### GRUPET E EVROPA LIGËS

**Grupi A:** Bayer Leverkusen, Ludogorets, Zurich, AEK Larnaca  
**Grupi B:** Salzburg, Celtic, Leipzig, Rosenborg  
**Grupi C:** Zenit, Kobenhavn, Bordeaux, Slavia Praha  
**Grupi D:** Anderlecht, Fenerbahçe, Dinamo Zagreb, Spartak Trnava  
**Grupi E:** Arsenal, Sporting, Qarabag, Vorskla Poltava  
**Grupi F:** Olympiacos, Milan, Real Betis, Dudelange  
**Grupi G:** Villarreal, Rapid Wien, Spartak Moskva, Rangers  
**Grupi H:** Lazio, Marseille, Eintracht Frankfurt, Apollon  
**Grupi I:** Beshiktash, Genk, Malmo, Sarpsborg  
**Grupi J:** Sevilla, Krasnodar, Standard Liege, Akhisar Belediyespor  
**Grupi K:** Dynamo Kyiv, Astana, Rennes, Jablonec  
**Grupi L:** Chelsea, PAOK, BATE Borisov, Vidi

spanjollët e Betis Sevillës, ndërsa ekipi i katërt Dudelange nga Luksemburgu duket më i dobët në letër. Kundërshtarët e Arsenalit në Grupin E do të jenë Sporting Lisbona, Qarabagu e Vorskla. Fat më të mirë ka pasur Chelsea, që duket se nuk do ta diskutojë kualifikimin në Grupin L kundër PAOK-ut, Bates dhe Vidit. Finalja do të zhvillohet në Baku të Azerbajxhanit më 29 maj 2019.

## Mourinho lavdëron vetën dhe Unitedin



MANCHESTER, 31 GUSHT - Jose Mourinho është rikthyer të flasë për mediet britanike. Në prononcimin e dhënë për "The Mirror", portugezi vazhdon në stilin e tij. Fenomen në statistika dhe mjeshtër i fjalës. Mourinho arrin deri te filozofi gjerman Hegel dhe e mbyll me tifozyt e Tottenhamit. "Unë jam menaxheri i një prej klubeve më të mëdha në botë, por jam gjithashtu një nga menaxherët më të mëdhenj në

botë. Unë arrita shumë suksese sezonin e kaluar dhe juve ndoshta nuk ju pëlqen ta pranoni këtë gjë. Unë i analizoj performancat e mia dhe për mua është më e rëndësishme ajo çfarë mendoj unë sesa ajo çfarë mendoni ju. E përsëris, që dy vjet më parë ne bëmë një sezon fantastik duke fituar Evropa Ligën. Të gjithë mendojnë se Atletiko i Madridit ishte i mahnitshëm, sepse fitoi Evropa Ligën, pasi u eliminua nga Liga e

Kampionëve. Në fituam atë trofe, sepse ai ishte niveli ynë. Ne jemi ekipi i fundit anglez që kemi fituar një trofe evropian. E përsëris, kam fituar tetë tituj kampionë. Jam i vetmi trajner në botë që kam fituar në Itali, Spanjë dhe Angli. Tetë tituj kampionë dhe jo tituj të vegjël ose në kampionate të vogla. Mendoj se vendi i dytë në sezonin e fundit ishte një ndër arritjet më të mëdha në karrierën time", ka thënë Mourinho.

### SHKURT

#### Lojtari i Bayernit, afër Shqipërisë

Futbollisti shqiptar i Bayern Munchenit, Meritan Shabani, është afër t'i bashkohet Kombëtares së Shqipërisë. Lajmin e ka bërë me dije Alban Bushi, trajner i Shqipërisë U21. "Edhe Meritan Shabani i Bayern Munchenit është shumë pranë Kombëtares", ka thënë Bushi. Interesim për Shabanin ka shprehur edhe Kosova, por pritet që e ardhmja e lojtarit "bavarez" të mësohet shumë shpejt.

#### Modriqi: Jam i lumtur në Real

Pas spekulimeve për kalim tek Interi, Luka Modriq ka insistuar se është i lumtur në Real Madrid. Modriqi u shpall lojtari i vitit nga UEFA 2017-18. Ai ka deklaruar: "Jam i lumtur me ekipin më të mirë në botë dhe dua të qëndroj këtu".

#### Vonni: Ky do të jetë sezoni im i fundit

Skiatorja amerikane Lindsey Vonn përmes një postimi në faqen zyrtare në "Instagram" ka konfirmuar se do të tërhiqet në fund të sezonit që nis në tetor, por vetëm në rast se do t'i thyejë rekordet. Deri më tani, ajo ka triumfuar 82 herë në garat e Kupës së Botës në ski, si askush tjetër, por dëshira për të garuar është ende e madhe, edhe pse sezonet e fundit janë mbushur me dëmtime të shpeshta. Skiatorja amerikane, që në Lojërat Olimpikë ka fituar edhe një medalje të artë, ka deklaruar: "Ky është sezoni i fundit i karrierës sime". Ndaj sezoni që do të nisë pas dy muajsh mund të jetë një tur lamtumire për skiatorën amerikane, që katër herë është shpallur fituese e Kupës së Botës, duke qenë edhe skiatorja femër me më shumë fitore në garat e këtij sporti. Por ajo konfirmon se kërkon ta thyejë rekordin e 86 fitoreve që mbahet nga legjenda suedeze Ingemar Stenmark. "Nëse këtë sezon nuk i arrij pesë fitore mund të vazhdoj të garoj", ka thënë Vonni.

#### Juve e dëshiron Bonaventuran

Juventusit po planifikon transferimin e mesfushorit të Milanit, Giacomo Bonaventura. "Zonja e Vjetër" italianin e dëshiron në afatin kalimtar të janarit, pasi ai pëlqehet shumë nga trajneri Massimiliano Allegri. 29-vjeçari në të kaluarën ka luajtur edhe për Padovën dhe Atalantën.

#### Trappi huazohet te Frankfurti

Portieri i Paris Saint-Germain, Kevin Trapp, është rikthyer në ish-klubin e tij, Eintracht Frankfurt, si huazim deri në fund të sezonit. Portieri gjerman iu bashkua PSG-së në vitin 2015, por me ardhjen e Gianluigi Buffonit ai u bë portieri i tretë në klubin francez. Portieri i dytë është Alphonse Areola.

#### Bernati shkon te PSG-ja, Boatengun qëndron në Bayern

